

AKT THEMELIMI
I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
SHOQERIA "TREVOR"

Në Lezhë, sot më 15.01.2025 themelojme shoqerine "TREVOR" SHPK nga themeluesi:

1. **Z. Ajet Shala** me atësi Habib, amesi Fatme, i datelindjes 27.01.1959, lindur ne Kopiliq i Poshtem, Kosove dhe banues ne Kopiliq i Poshtem, Kosove, shtetas Kosovar, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. ID2358012 dhe me nr. personal 1030650448.

Themelojme sipas kërkesave te ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008, dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare te Biznesit ", si me poshtë:

NENI 1

Te krijoj shoqërinë tregtare me forme ligjore Shoqeri me Përgjegjësi te Kufizuar me emrin TREVOR e cila do te veproje ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet qe duhen plotësuar ne te.

NENI 2

Selia e Shoqërise " TREVOR " do te jete ne adresen: Lezhe, Lezhe, Shenkoll, Tale, Gryke lumi, zona kadastrale 1879, pasurine nr. 11/192.

NENI 3

Shoqëria do te ketë për objekt te veprimtarisë te saj ushtrimin e aktivitetit ne fushën e “**Agjensi ndermjetesim shit-blerje pasuri te paluajtshme**” dhe do te ushtroje veprimtarinë e saj private për një periudhe kohore te pacaktuar, ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 4

Shoqëria mund te ndryshoje emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë se saj etj me vendim te ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë do te jete: **800,000 (teteqind mije) leke** e përbërë nga 1 (nje) kuota qe i perkasin ortakeve si me poshte.

1. - **Ajet Shala** me 100 % te kapitalit = 1 kuote = 800,000 leke

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund te shtohet ose te pakësohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket, por ne asnjë rast njeri

ortak nuk mund te detyroje ortaket e tjerë te rrisin kuotën e tyre ne kapitalin e shoqërisë.

Ne rast se kapitali i shoqërisë për shkak te humbjeve te vërtetuara ne dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive te përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes se parakohshme te shoqërisë. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlere jo me te vogël se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Ortaku qe ka ndërmend t'u shesë te tretëve kuota te kapitalit te tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet te njoftoje me pare ortaket e tjerë te shoqërisë, te cilët kane te drejtën e parablerjes qofte dhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit. Për hollësi te mëtejshme ortaket do ti referohen dispozitave te parashikuara ne Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr. 9901 date 14.04.2008.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqërisë jane:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori

Procedura për emërimin ne funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqërisë.

NENI 9

Administrator do jete **Z. Ajet Shala** me atësi Habib, amesi Fatme, i datelindjes 27.01.1959, lindur ne Kopiliq i Poshtem, Kosove dhe banues ne Kopiliq i Poshtem, Kosove, shtetas Kosovar, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr. ID2358012 dhe me nr. personal 1030650448.

Administratori zgjidhet për nje afat 5 vjecar me te drejte ripërtëritjeje.

NENI 10

Vendimet e Asamblesë janë te vlefshme ne se janë miratuar nga ortaket e saj sipas dispozitave te Ligjit Për Shoqëritë Tregtare ne lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave ne kapitalin themeltar për Asamblenë e Zakonshme dhe te Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes se Asamblesë se Zakonshme dhe te Jashtëzakonshme, kompetencave te ortakeve dhe marrjes se vendimeve do te bazohet ne statutin e shoqërisë si dhe ne Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar te shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do te shënohet kontributi i ortakut te vetem. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave te ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave te tjera financiare, te domosdoshme për veprimtarinë normale te saj.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do të ndahet ndërmjet ortakut të vetëm mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet, dhe të jete hequr 5% që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1/10 të kapitalit të shoqërisë.

NENI 13

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në katër dokumente origjinale me fuqi të barabartë secila.

ORTAK I VETEM I SHOQERISE

1. Ajet Shala

